

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-23-7240-2-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Zeqir M. Krasniqi B.I.
NUI	810634198
Adresa	Rruga Hajdin Berisha Pn.
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Krasniqi
Adresa elektronike	autokrasniqi@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	30.08.2023

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

OE i rekomanduar, është në grup me një OE i cili bazuar në informatat e biznesit NUK e ka asnjë veprimtari për SERVISIM të automjeteve, por të gjitha i ka TREGTI, si veprimtarinë primare ashtu edhe veprimtaritë tjera, ky anëtar i grupit nuk e ka asnjë veprimtari SHËRBIM siq është edhe Lloji i kësaj procedure të prokurimit.

Në këtë procedurë AK ka cekur se lloji i kontratës është:

Lloji i kontratës: 2 Shërbime

Ndërsa këto janë veprimtaritë e OE të rekomanduar (të gjitha tregti):

Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesoreve të automjeteve

Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar

Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to

Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël

Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i veturave dhe automjeteve të lehta motorike

Tregtia e automjeteve të tjera

Kjo është në kundërshtim me nenin 66 të LPP-së:

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

Përshtatshmëria Profesionale

Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatojë aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend.

Pra AK ka rekomanduar një GOE në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe ka shkelur nenin 1 të LPP-së si dhe duke na dëmtuar neve nuk na ka trajtuar të barabartë siq kërkohet me nenin 7 të LPP-së.

Për më tepër, nëse e analizojmë Listën e kontratave të ofruara nga GOE, të njëjtat nuk janë siq është kërkuar me FDT në pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjajshme në vlerë prej minimumi 60,000.00 gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar përveq që ka ofruar kontrata të furnizimeve, të njëjtat janë me blerës privat dhe nuk janë mbështetur me dëshmi të qarkullimit bankar siq kërkohet me nenin: 25 të Rregullores së prokurimit publik dhe është në kundërshtim me Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së.

Po ashtu bazuar në kërkesat e FDT-së OE është dashur të ofrojnë dëshmi për kapacitetin teknik e profesional si në vijim:

Operatori Ekonomik duhet të posedoj autolarje jo më larg se 5 (pesë) km nga territori i Mamushës ose mareveshje me ndonjë autolarje brenda distancës së kërkuar më lartë.

GOE ka ofruar një marëveshje me një person fizik (edhe pse e ka cekur emrin e biznesit), i cili ka nënshkruar këtë marëveshje, por e njëjta nuk është vërtetuar. Pas kësaj ne kemi verifikuar në ARBK këtë biznes dhe i njëjti nuk figuron fare. Pra GOE ka ofruar dëshmi në kundërshtim me kërkesat e FDT-së për më tepër ka ofruar dëshmi në kundërshtim me

LPP-në dhe AK është dashur ta trajtojë konform nenin 99.2 e LPP-së duke kërkuar që ky GOE të futet në Listën e zezë nga ana e OSHP-së e jo të rekomandohet për kontratë siq ka vepruar AK.

AK po ashtu ka kërkuar në FDT që Oe të dorëzojnë të dorëzojnë deklaraten për ST në pikën: 2.5 të DT: Specifikacionet teknike te detyrueshmeL
Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për punët e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet, vulozet dhe me tender të dorëzohet aneksi nr. 7 i kësaj dosje të tenderit);

GOE nuk e ka dorëzuar një deklaratë të tillë dhe është dashur të eliminohet nga gara e jo të rekomandohet si fitues.

Pra AK me rekomandimin që ka bërë dhe vendimin e publikuar me datë: 29.08.2023, ka vepruar në kundërshtim me nenet : 1,7, 59, 69 të LPP-së.

Andaj kërkojmë që AK të aprovojë kërkesën për RISHQYRTIM , të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe të na shpall ne fitues si OE i përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si OE per nje periudhe te gjate punojne ne servisim te automjeteve dhe kemi disa kontata me AK, andaj ne rast se nuk trajtohem te barabart nga AK perveq demeve financiare, na shkaktohen edhe deme morale

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*